

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, Gjyqtari Berat Spahiu, me sekretaren juridike Xhemile Bejtullahu, në qështjen kontestimore të paditësit-kundër të paditurit B. M nga Gj, të cilin e përfaqëson me autorizim S.M..., kundër të paditurit-kundërpaditësit I.Mnga fshati..., për shkak të kompenzimit të dëmit dhe pagesën e borgjit, pas shqyrtimit të fundit kryesor dhe publik, më datë 16.07.2013, mori këtë

A K T G J Y K I M

I. APPROVOHET PJESËRISHTË kërkesëpadia e paditësit-kundër të paditurit B.M.dhe **OBLIGOHET** i padituri-kundërpaditësi I.M nga fshati B- që paditësit t'ia paguaj shumën e të hollave në lartësi prej 350€, në emër të kompenzimit të dëmit për moskryerjen e punëve në mënyrë profesionale në muratimin e shkallëve në shtëpinë e paditësit e cila gjendet në Gjilan, me kamatë bankare prej 4.3%, duke filluar nga data 27.09.2010, si datë e parashtrimit të padisë në gjykatë, e deri në pagesën definitive, krejt në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm.

II. REFUZOHET SI E PABAZUAR pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësit në lartësi prej 981€, e kërkuar më tepër se shuma e gjykuar, lidhur me kompenzimin e dëmit për kryerjen e punëve joprofessionale nga ana e të paditurit në shtëpinë e paditësit në Gj.

III. REFUZOHET SI E PABAZUAR kundërkërkesëpadia e të paditurit-kundërpaditësit I. M nga B, e ushtruar kundër paditësit –kundër të paditurit nga Gj, me të cilën kundërpaditësi ka kërkuar që të obligohet kundër i padituri B. M, që kundërpaditësit I.M t'ia paguaj borgjin në lartësi prej 2,786€, në emër të kryerjes së punëve në shtëpinë e paditësit si punë shtesë të kryera jashtë marrveshjes me shkrim të palëve, e në përputhje me marrveshjen gojore të tyre, me kamatë prej 3.5% duke filluar nga dita e përfundimit të ndërtimit të shtëpisë, nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm.

IV. Secila palë i bartë shpenzimet e veta gjyqësore, kurse palët ndërgjyqëse janë obliguar që kësaj gjykate t'ia paguajnë në pjesë të barabarta shumën e të hollave në lartësi prej 50€, në emër të përpilimit me shkrim të aktgjykimit, krejt në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm.

A R S Y E T I M

Paditësi –kundër i padituri B.M. nga Gj, përmes përfaqësuesit të tij me autorizim S. M avokat nganë këtë gjykatë ka ushtruar padi ndaj të paditurit ,,nga B, me të cilën paditësi –kundër i padituri ka kërkuar që të obligohet i padituri-kundërpaditësi që paditësit t'ia paguaj shumën e të hollave prej 1,331€, në emër të kompenzimit të dëmit për moskryerjen e punëve në mënyrë profesionale në ndërtimin dhe muratimin e shtëpisë së tij në Gjilan.

Paditësi në padi ka theksuar se të gjitha punët janë kontraktuar me paditësin dhe janë evidentuar në marrveshjen e tyre me shkrim të përpiluar më datë 08.04.2010.

I padituri-kundërpaditësi I. Mnga B, në përgjegjëjen në padi dhe gjatë shqyrtimeve kryesore ka kundërshtuar kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar, duke theksuar se punët janë kryer në mënyrë profesionale dhe nën mbikqyrjen e paditësit, i cili po mos të ishte i kënaqur me kualitetin e punëve ndërtimore me siguri se do të urdhëronte ndalimin e kryerjes së mëtejme të punëve ndërtimore.

I padituri ka deklaruar se me propozimin e paditësit janë kryer punët shtesë dhe jashtë marrveshjes me shkrim të tyre, në mënyrë që paditësi më vonë t'ia kompenzojë këto punë me të holla, dhe pas dështimit në realizimin e kërkesës së tij, i padituri në këtë gjykatë ka ushtruar kundërpadi ndaj paditësit, me të cilën ka kërkuar që të obligohet kundër i padituri....., që kundërpaditësitt'ia paguaj borgjin në lartësi prej 2,786€, në emër të punëve shtesë të kryera në shtëpinë e paditësit, me kamatë prej 3.5% duke filluar nga dita e përfundimit të ndërtimit të shtëpisë, nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm.

Paditësi-kundër i padituri për provë të pohimeve të veta gjykatës i ka propozuar që të shtjellojë provat materiale edhe ato: Kopjen e ekspertizës së datës 17.09.2010, të kryera nga Sh. Nng.dipl. arkitekturës, Marrveshjen për kryerjen e punëve të dt.08.04.2010, Ekspertizën gjyqësore të ekspertit të ndërtimtarisë në mënyrë që të vlersohen në mënyrë profesionale punët e kryera në shtëpi, dhe dëgjimin e tij në cilësi të palës.

Përfaqësuesi i paditësit-kundër të paditurit në fund ka kërkuar shpenzimet gjyqësore duke i secifikuar ato në kuptim të nenit 463 të LPK-së.

I padituri ka propozuar që për vërtetimin e pohimeve të veta në kundërpadi, gjykata të shtjellojë pos provave të propozuara nga paditësi edhe dëgjimin e dëshmitarëve N dhe N.t M që të dy nga B dhe dëgjimin e tij si palë ndërgjyqëse.

I padituri-kundërpaditësi i ka kërkuar shpenzimet gjyqësore por nuk i ka specifikuar ato.

Pas administrimit të të gjitha provave një nga një dhe të gjitha së bashku, si në kuptim të nenit 8 të LPK-së, dhe nga rezultati i gjithmbarshëm provues, gjykata vërtetoi këtë gjendje faktike:

Me dëgjimi e palëve ndërgjyqëse dhe me administrimin si provë të Marrveshjes me shkrim mbi kryerjen e punëve të dt.08.04.2010, të lidhur në mes të paditësit dhe të paditurit, gjykata vërtetoi faktin se palët ndërgjyqëse në muajin prill të vitit 2010, ishin marr vesh në mes tyre që i padituri në cilësi të kryesit të punëve ndërtimore, ti kryej punët ndërtimore të përshkruar sipas marrveshjes, kurse paditësi në cilësi të punëdhënësit t'ia shpërblej të paditurit punët e kryera sipas marrveshjes me shkrim në lartësi prej 12,200€, ashtu që sipas marrveshjes dhe deklaratës së vet të paditurit – kundërpaditësit, t; dhënë gjatë shqyrtimit kryesor, punëdhënësi ia ka dhënë atij shumën e të hollave prej 11.700€, ashtu që shuma prej 500€, nuk ju ka paguar të paditurit – kundërpaditësit për shkak se shtruarja e ibercukut që ishte paraparë në marrveshjen me shkrim ishte kryer nga ana e vet paditësit.

Me daljen e gjykatës në vendin e ngjarjes dhe nga ekspertiza e ekspertit të ndërtimtarisë R.S. e dt. 20.05.2013, gjykata vërtetoi faktin se punët ndërtimore të porosituar nga paditësi përveq muratimit të shkallëve, janë kryer sipas standardeve të mesme të ndërtimit, standarde këto që aplikohen në ndërtimtarinë e ulët në Kosovë.

Nga plani dhe marrveshja mbi kualitetin e ndertmive, i padituri si punëkryers kishte devijuar në muratimin e shkallëve në shtëpinë e paditësit, për qka sipas ekspertit për drejtimin e tyre dhe dhënjes së formës estetike të tyre, paditësit i duhet që të angazhoj punë shtesë me veshjen e tyre me stiropor ku do të shpenzonte shumën e të hollve prej 350€.

Kurse sa i përket kërkesave tjera për dëmshpërblim, sipas ekspertit i padituri ju ka përmbajtuar standardeve të ndërtimit dhe nuk është përgjegjës.

Faktin se paditësi-kundër i padituri kërkon dëmshpërblim për mos shtrirjen e rrjetit të energjisë elektrike në katin e fundit apo në katin e tretë dhe ndërtimi i oxhakut të ngrohjes qëndrore, janë të pabazuara, pasi që këto punë nuk janë paraparë me marrveshjen e palëve mbi kryerjen e punëve të dt.08.04.2010, e në anën tjetër paditësi me asnjë provë nuk e ka argumentuar faktin se kanë pasur marrveshje tjetër mbi kryerjen e punëve shtesë, pos asaj me shkrim të dt.08.04.2010

Gjykata pjesërishtë besimin ia shprehu ekspertizës së ekspertit të ndërtimtarisë dt.20.05.2013, në pjesën ku ekseptri ka deklaruar edhe gjatë shqyrtimit kryesor, se punët tjera janë kryer sipas standardeve profesionale të ndërtimit, përveq muratimit të dobët të shkallëve, për qka paditësi duhet të shpenzoj edhe 350€, për përmirsimin e tyre.

Faktin se në ekspertizë janë cekur analiza të qmimit për diferencën e pagesës së qmimit nga marka e montave të firmës “.....”, me monta të stiroporit, ndërimi i shtëpisë në dy kulme apo në dy ujra siq është e shperhur në popull kjo fjalë, nga marrveshja paraprake për një kulm, montimi i mermerit në dritare dhe ndërtimi i oxhakut për ngrohje qëndrore janë fakte të cilat shkojnë në favor të të paditurit, pasi që këto veprime nuk janë paraparë në marrveshjen me shkrim të palëve, por të cilat fakte edhe I padituri nuk ka arritur që ti dëshmoj me kundërpadi, fakt ky që do të arsyetohet më poshtë.

Paditësi për vërtetimin e të gjitha fakteve të paraqitura në padi, i ka propozuar gjykatës që të shtjellohet si provë marrveshja me shkrim mbi kryerjen e punëve dt.08.04.2010, ashtu që gjykata në bazë të marrveshjes me shkrim ka vërtetuar se i padituri iu ka përmbajtur në përgjithësi kësaj marrveshje, pos muratimit të shkallëve.

Gjykata nuk ia shprehu besimin ekspertizës private të ing. Dipl. Sh.N arkitekthe, të përpiluar në mënyrë private dhe me porosi të vet paditësit, pasi që kjo provë materiale është marrur jasht sencës gjyqësore dhe si e tillë nuk ka mundur të ndikoj në marrjen e një vendimi tjetër nga gjykata.

Fakti se paditësi në deklaratën e tij ka dhënë pohime tjera për moskryerjen e punëve në mënyrë profesionale nga ana e të paditurit, gjykata nuk ka mundur tia shpreh besimin e saj pasi që deklaratat e palëve janë mjete i fundit provues në procedurën provuese, e të cilave gjykata nuk guxon tia shpreh besimin plotësisht, pasi që palët në kontest gjithmon tentojnë ti shtrembrojnë faktet për ti mbrojtur interesat e tyre.

Prandaj duke u bazuar në ekspertizën ekspertit të ndërtimtarisë së dt.20.05.2013, gjykata e pranoi pjesërisht kërkesdëpadinë e paditësit si të bazuar me ligj, duke e përcaktuar edhe lartësinë e kamatës prej 4.3%, aq sa paguajnë tani Bankat Komerciale në Kosovë, për mjetet e deponuara pa destinim të veqant.

Gjykata e ka refuzuar kundërkërkesëpadinë e kundërpaditësit si të pabazuar me ligj, pasi që kundërpaditësi Isak Muji nuk ka arritur të dëshmoj me asnjë provë materiale se ka kryer punë shtesë tek paditësi në cilësi të punëkryersit, edhe ate jasht marrveshjes me shkrim, pasi që dëshmitarët e propozuar nga vet ai dhe të ndëgjuar nga gjykata Nuhi dhe Nexhat Muji nga Bresalci kanë deklaruar se nuk kanë qenë prezent me rasstin e arritjes së marrveshjes mbi kryerjen e punëve.

Duke u nisur nga fakti se barra e provave bie në palën e cila pretendon realizimin e një të drejte, gjykata e refuzoi kërkesëpadinë e kundërpaditësit si të pabazuar me ligj, pasi që ai nuk ka arritur të dëshmoj themelësinë e kërkesëpdisë së tij

Në bazë të nenit 452.4 të LPK-së, gjykata vendosi që secila palë ti heq shpenzimet e veta gjyqësore, kurse në mënyrë të barabart tia paguajnë kësaj gjykate shumën e të hollave në lartësi prej 50€, për përpilimin e aktgjykimit, duke marrur parasysh vlerën e objektit të kontestit dhe faktin e ushtrimit të padisë dhe kundërpadisë.

Nga të cekurat më lartë, e bazuar në nenin 143 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil
Më datë, 16.03.2013

Gjyqtari

Berat Spahiu

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi, mund të ushtrohet ankesë Gjykatës së Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit, përmes kësaj gjykate.